

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm]

Nr. i rastit P.8/13

### NË EMËR TË POPULLIT

24 nëntor 2017

Gjyqtarja e EULEX-it Marie Tuma, duke vepruar në cilësinë e kryetares së trupit gjykues dhe gjyqtarja e EULEX-it Jennifer Seel dhe gjyqtari i Kosovës Isuf Makolli si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësin Azem Havolli

Në çështjen penale kundër të akuzuarve:

1)

Emri	F.
Mbiemri	L.
Emri i babës	XXX
Data e lindjes	XXX
Vendi i lindjes	XXX
Gjinia	Mashkull
Adresa	XXX
Kombësia	Shqiptar Kosovar
Shtetësia	Kosovar
Profesioni	Ish Ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit (2008-2010)
ID	XXX

2)

Emri	E.
Mbiemri	Sh.
Emri i babës	XXX
Data e lindjes	XXX
Vendi i lindjes	XXX
Gjinia	Mashkull
Adresa	XXX
Kombësia	Shqiptar Kosovar

Shtetësia	Kosovar
Profesioni	Ish Shef i Kabinetit dhe Këshilltar Politik i F.L. (2008-2010)
ID	XXX

3)

Emri	N.
Mbiemri	K.
Emri i babës	XXX
Data e lindjes	XXX
Vendi i lindjes	XXX
Gjinia	Mashkull
Adresa	XXX
Kombësia	Shqiptar Kosovar
Shtetësia	Kosovar
Profesioni	Ish Shef i Prokurimit, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
ID	XXX

4)

Emri	F.
Mbiemri	Z.
Emri I babës	XXX
Data e lindjes	XXX
Vendi i lindjes	XXX
Gjinia	Mashkull
Adresa	XXX
Kombësia	Shqiptar Kosovar
Shtetësia	Kosovar
Profesioni	Pronar i Kompanisë Kompania T. nga Gjilani
ID	XXX

5)

Emri	Sh.
Mbiemri	T.
Emri I babës	XXX
Data e lindjes	XXX
Vendi i lindjes	XXX
Gjinia	Mashkull
Adresa	XXX
Kombësia	Shqiptar Kosovar
Shtetësia	Kosovar
Profesioni	Ish Truproje i F. L.

Të akuzuar për veprat penale në vijim sipas Aktakuzës PPS rr. 425/09 e datës 5 dhjetor 2012 dhe PPS nr. 67/10 e datës 18 shkurt 2014, të bashkuara në Aktakuzën PPS nr. 425/09 e datës 28 shtator 2015:

**Pika 1 e aktakuzës** kundër F.L., E.Sh, N.K.dhe Sh.T.: **Krimi i Organizuar** në shkelje të nenit 274 paragrafi 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), siç lexohet me nenin 274, paragrafi 1 të KPPK-së e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri 20 vjet; lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje) siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015;

**Pika 2 e aktakuzës** kundër F.L., E.Sh, N.K.dhe Sh.T.: **Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit** në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1 dhe 3 të KPPK-së e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet dhe e lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje), për F.L. dhe N. K. dhe e lexuar në lidhje me nenin 25 të KPPK-së (ndihma) për E.Sh dhe Sh. T.; lexuar gjithashtu në lidhje me nenin 117.1.a dhe d. të Ligjit për Prokurimin Publik dhe gjithashtu lexuar në lidhje me veprën penale të mëposhtme Marrja e ryshfetit siç është specifikuar në Pikën 3 të Aktakuzës siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015.

**Pika 3 e aktakuzës** kundër F.L., E.Sh dhe N.K: **Marrja e Ryshfetit**, në kundërshtim të nenit 343 paragrafi 1 i KPPK-së dhe e dënueshme me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet; lidhur me nenin 23 të KPPK-së (bashkë-kryerje); dhe lidhur me nenin 117.1.a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015;

**Pika 4 e aktakuzës** kundër F. Z.: **Dhënia e Ryshfetit** në kundërshtim të nenit 344 paragrafi 1 të KPPK-së; e dënueshme me burgim prej tre muaj deri në tre vjet lidhur me nenin 117.1.a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015.

**Pika 5 e aktakuzës** kundër F. Z.: **Keqpërdorimi i Autorizimeve në Ekonomi** në kundërshtim të nenit 236 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 dhe paragrafi 2 i KPPK-së; e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015;

dhe

**Pika 6 e aktakuzës** kundër F.L.: **Vepra të tjera penale në formë të mos-Deklarimit të Parave të Pranuarra për Fushatë në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale**, siç është ndryshuar, Neni 5.1 lexuar me nenin 10.8 e dënueshme me burgim deri dy vjet dhe gjobë deri në 5000 Euro apo me dyfishin e shumës së valutës së pranuar, cilado prej tyre që është më e lartë, nenin 5.6 lexuar me nenin 10.5 e dënueshme me burgim deri pesë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 Euro siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, para trupit gjykues aktual në seancat gjyqësore publike, në mënyrë të barabartë në prani të prokurorit, të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 23 nëntor 2017 në pajtim me nenin 357 të Kodit të Procedurës Penale (KPP);

Në pajtim me nenin 362, 363, 364, 366, 450, 454 dhe 463 të KPP-së,

Në mënyrë unanime nxjerr këtë:

## AKTGJYKIM

**1. Pika 1 e aktakuzës kundër F.L., E. Sh, N. K. dhe Sh. T.: Krimi i Organizuar** në shkelje të nenit 274 paragrafi 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), siç lexohet me nenin 274, paragrafi 1 të KPPK e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri 20 vjet; lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje) siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015: të akuzuarit **Të akuzuarit LIROHEN NGA AKUZA në pajtim me nenin 364, paragrafi 1 (1.1) të KPP-së, sepse veprat me të cilat ata akuzohen nuk përbëjnë veprën penale të Krimin të Organizuar.**

**2. Pika 2 e aktakuzës kundër F.L., E. Sh, N .K .dhe Sh .T.: Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit** në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1 dhe 3 të KPPK-së e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet dhe e lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje), për F.L. dhe N. K .dhe e lexuar në lidhje me nenin 25 të KPPK-së (ndihma) për E. Sh. dhe Sh. T.; lexuar gjithashtu në lidhje me nenin 117.1.a. dhe d. të Ligjit për Prokurimin Publik dhe gjithashtu lexuar në lidhje me veprën penale të mëposhtme Marrja e ryshfetit siç është specifikuar në Pikën 3 të Aktakuzës siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015: **Të akuzuarit LIROHEN NGA AKUZA në pajtim me nenin 364, paragrafi 1 (1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se ata i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar. Në mënyrë të veçantë, nuk është provuar se:**

- F.L., E. Sh. dhe N.K. kanë shpërdoruar pozitën e tyre zyrtare përmes kryerjes së bisedimeve, premtimeve dhe dhënies së tenderëve për ndërtimin e rrugëve kompanive të ndërtimit Kompania T. dhe Kompania I-E. në shkëmbim të kërimit dhe marrjes së ryshfeteve. Tenderët u janë dhënë duke anashkaluar dhe manipuluar rregullat ligjore të prokurimit në shkelje të nenit 6.2 të Ligjit të Prokurimit Publik, që e ndalon favorizimin e një kompanie mbi një tjetër, në çdo fazë të procedurës së prokurimit;
- Sh. T. ndihmoi F.L. dhe N.K. për të manipuluar procedurat e tenderit duke kryer aranzhime për marrëveshje private duke negociuar, duke bartur dokumente të tenderit, duke kërkuar para dhe duke bartur komunikimin privat – përfshirë premtime për dhënie të tenderit – ndërmjet përfaqësuesit të kompanisë A. A .dhe F.L. para dhe gjatë procesit të tenderit;
- E. Sh. dhe N. K. kanë ndihmuar kompaninë Kompania T. që t’i “rregullonte” dokumentet për tender, ndërsa F.L. i kishte premtuar M. Sh. nga kompania Kompania I-E. se do t’ia “rregullonte” dokumentet e tenderit, duke i sugjeruar Shkodrës që të takohej me N. K. Ndihma - “rregullimi” i dokumenteve të tenderit përbën shkelje të nenit 61.1.b të Ligjit të Prokurimit Publik;
- Gjatë rrjedhës së negociimit të ryshfeteve, E. Sh. gjithashtu i ka negociuar me F.Z .edhe specifikimet e tenderit gjatë periudhës kohore ndërmjet paraqitjes së ofertës dhe dhënies së

kontratës, çka përbën shkelje të nenit 57.2 të Ligjit të Prokurimit Publik. F.L. dhe N. K. kanë zhvilluar komunikime të ngjashme me M. Sh. duke shkelur kështu nenet 53 dhe 57.2 të Ligjit të Prokurimit Publik;

- Ndërkohë që M. Sh. nga kompania Kompania I-E. kishte refuzuar të paguante ryshfetin e kërkuar prej 20%, F. Z. nga kompania Kompania T. kishte rënë dakord që të paguante ryshfetin e kërkuar prej 20%. Negociatat dhe dhënia e tenderit nën kushtin e pagesës së ryshfeteve përbën një shpërdorim të rëndë të funksioneve publike që kishin të dyshuarit, si dhe të interesit publik ndaj këtyre zyrtarëve publikë që duhej të jepnin vendime detyruese mbi bazën e pa-anshmërisë dhe ndershmërisë;
- F.L., E. Sh. dhe N.K. kanë shpërdoruar pozitat e tyre me qëllimin për të nxjerrë përfitime materiale dhe për të mbledhur dhe kërkuar paratë e ryshfeteve. Duke ndihmuar kompanitë për paraqitjen e ofertave përmes rregullimit të dokumentacionit të tyre dhe duke ua dhënë tenderët kompanive të caktuara, përmes anashkalimit të rregullave të prokurimit, ata kanë pasur edhe qëllimin që këto kompani të nxirrnin përfitime të paligjshme materiale për veten e tyre. Përfitimi për kompanitë *Kompania T.* dhe Kompania M. lidhur me tenderët e përshkruar në Pikën 1 të Aktakuzës dhe arrijnë shumën prej 2.476.607,59 Euro;
- In Në lidhje me tenderin për ndërtimin e rrugës Ponesh- Zhegovc në Gjilan, F.L. është takuar privatisht me M. Sh. nga kompania I-E., duke e këshilluar atë që të paraqiste ofertë bashkë me kompanitë e tjera që të fitonte tenderë për projektet e ardhshëm të MTPT; kështu duke ndërhyrë në dhe shkelur pa-anshmërinë e proceseve të tenderimit në MTPT. N. K. kishte nënshkruar kontratë me kompaninë Kompania T. edhe pse kishte pasur dijeni mbi faktin se F. Z. nga *Kompania T.* e kishte fituar tenderin mbi bazën e një marrëveshjeje për rregullimin e çmimit me kompaninë që i përkiste vëllait të tij, N. Z. nga kompania Z. C. dhe për më tepër duke qenë gjithashtu në dijeni të faktit se tenderi ishte dhënë si rezultat i shkeljeve të bëra të ligjeve themelore të prokurimit, që përcaktohen në Ligjin mbi Prokurimin Publik. Ndërkohë që ruga ndërtohej, E. Sh edhe pse ishte njoftuar nga F.Z. se “komisioni nuk do ta pranonte atë”, e kishte udhëzuar F.Z. që të vazhdonte me ndërtimin e rrugës, gjë të cilën F.Z. e kishte pranuar duke i thënë E. Sh. se ai ishte “një mbret”.
- Sa i përket tenderit për mirëmbajtje verore në rajonin Gjilanit 2008, N.K. ka nënshkruar tenderin për Kompaninë M. përkundër të diturit se F. Z. nga Kompania T. Kompani ka hyrë në marrëveshje për rregullimin e çmimeve me E. Kompaninë dhe kështu që të dy kompanitë është dashur të diskualifikohen nga tenderi. Një skualifikim i tillë do të kishte bërë të nevojshme një përsëritje të të gjithë procesit. F. Z. megjithatë ka marrë dosjen e tenderit për Kompaninë Kompania T. më 1 shkurt 2008 dhe ka dorëzuar ofertën për Kompania T. më 29 shkurt 2008. Përkundër faktit që ai e ka pas të ndaluar hyrjen në marrëveshje për rregullimin e çmimeve me ofertues tjerë para dorëzimit të ofertave, apo në të kundërtën për të deklaruar haptazi se Kompania T. zyrtarisht ka ofertuar në një konsorcium me E. Kompani dhe kanë ndarë çmimin, F. Z. ka fshehur marrëveshjet për rregullimin e çmimin dhe ka manipuluar me çmime me E. fshehtazi;

- N.K., përkundër faktit se e ka ditur se janë bërë marrëveshje për rregullim çmimesh, ai megjithatë pranoi vazhdimin e procesit të tenderimit. Ai gjithashtu nuk ka raportuar tek autoritetet përkatëse mbi marrëveshjet e rregullimit të çmimeve ndërmjet të dy kompanive dhe ka nënshkruar kontratën me kompaninë fituese M. edhe pse ai ka ditur për paligjshmërinë e përfshirë në vazhdimin e procesit të tenderit;
- Për sa i takon tenderit për mirëmbajtjen verore dhe dimërore 2009 për rajonin e Gjilanit, F.L. e kishte udhëzuar M. Sh. nga kompania Kompania I-E që “të mos fliste dhe mirëmbajtja verore për rrugët për vitin 2009 do të jetë e jotja”. N. K., nën udhëzimet e F.L. e kishte specifikuar marrëveshjen duke i thënë M. Sh. së “ne do të depozitojmë tek ti 20% të shumës totale paraprakisht dhe ti pastaj do të na i japësh neve (këto) të holla”.
- M. Sh. nuk kishte pranuar të paguante ryshfetin dhe prandaj, N.K. i kishte thënë M. Sh. që të shkonte e të takohej me F.L. sërish, sepse ai ishte personi që i kishte premtuar atij tenderin më herët. Kur M. Sh. nuk kishte rënë dakord që të paguante ryshfetin e kërkuar, F.L. e kishte udhëzuar E. SH. që të negocionte një marrëveshje (ryshfeti) me F.Z. nga kompania Kompania T. për përfitimin e tij personal. E. Sh. pasi kishte biseduar për këtë çështje me “disa eprorë”, duke përfshirë F.L., e kishte siguruar F.L. që të mos “shqetësohej për mirëmbajtjen, unë do të merrem me të gjithë kohën”. Në mars 2009, pas diskutimeve të hollësishme që ishin zhvilluar lidhur me ryshfetin ndërmjet E. SH. dhe F. Z. (për të cilat kishte dijeni F.L.) kompanisë Kompania T. ju dha tenderi me vlerën prej 1.192.844,94 Euro në këmbim të pagesës së një ryshfeti që arrinte shumën prej 250.000,00 Euro që do t’i kalonte direkt familjes L. Të hollat e përfshira arrinin në 20% të vlerës së përgjithshme të tenderit. Hollësitë përkatëse mbi këtë marrëveshje ryshfeti përshkruhen më hollësisht në Pikat 5 dhe 6 të kësaj Aktakuze. Gjatë negociatave për këtë ryshfet, E. Sh. i kishte kërkuar F. Z. nga kompania Kompania T., më 24 mars 2009, të paraqiste dokumentet e tij të tenderit e dukshme që për qëllime manipulimi, duke i thënë atij: “Unë do të të tregoj ty se kur duhet t’i dorëzosh letrat dhe ne këtë do ta përfundojmë sepse edhe ata po i kërkojnë ato”.
- Në lidhje me tenderin 08/073/521 Asfaltimi i rrugës Duraj-Gabrice, F.L. e ka udhëzuar përmes një “letre” e cila ishte shkruar në Restorantin *Mani* në prani të përfaqësuesve të kompanisë B. (sipas të gjitha gjasave A.A.) duke nënvizuar se çfarë sasive parash duhet të jepte kompania B. për të qenë i suksesshëm me këtë ofertë. Sh. T. ndihmoi F.L. në vendosjen e komunikimit privat me A.A. kur procedura e tenderit kishte filluar. N. K., edhe pse ka ditur për marrëveshjet private dhe aranzhimet e bëra nga F.L., ka pranuar vazhdimin e procedurave të tenderit, nuk ka raportuar ndonjë keqpërdorim dhe ka nënshkruar kontratat me kompanitë fituese E. dhe B..

3. **Pika 3 e aktakuzës kundër F.L., E. Sh dhe N. K.: Marrja e Ryshfetit**, në kundërshtim të nenit 343 paragrafët 1 dhe 2 të KKPK-së dhe e dënueshme me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet; lidhur me nenin 23 të KPPK-së (bashkë-kryerje); dhe lidhur me nenin 117.1.a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin

Publik siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015: **të akuzuarit LIROHEN NGA AKUZA në pajtim me nenin 364, paragrafi 1 (1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se ata kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar, në mënyrë të veçantë:**

- Ndërmjet vitit 2007 dhe 2010, në Kosovë, F.L. në pozitën e tij zyrtare si Ministër në MTPT, E. Sh në pozitën e tij zyrtare si Këshilltar Politik në MTPT dhe Shef Kabineti në MTPT e N. K. në pozitën e tij zyrtare Shef i Departamentit të Prokurimit në MTPT, kanë pranuar premtime për pagesa ryshfeti në shkëmbim të dhënies së tenderit për ndërtimin e rrugës kompanisë Kompania T.. F. Z., si pronar i kompanisë Kompania T. kishte ofruar nga ana tjetër ryshfet që dokumentet e tij të tenderit “të rregulloheshin” dhe që t’i jepen tenderët e MTPT;
- Bisedimet për arritjen e një ujdje lidhur me tenderin për mirëmbajtjen verore dhe dimërore 2009 për rajonin e Gjilanit kishin filluar pasi bisedimet e para ndërmjet F.L., N. K. dhe dëshmitarit M.Sh. kishin rezultuar të pa-suksesshme. Për deri sa F.L. i kishte thënë M. Sh. që “mos fol dhe mirëmbajtja verore për rrugët për vitin 2009 do të jetë e jotja”. N. K., nën udhëzimet e F.L. e kishte specifikuar ujdinë duke i thënë M .Sh. së “ne do të depozitojmë tek ti 20% të shumës totale paraprakisht dhe ti pastaj do të na i japësh ne këto të holla”. M. Sh. në fund nuk kishte pranuar të paguante ryshfetin dhe prandaj, N. K. i kishte atij që të shkonte e të takohej me F.L. sërish, sepse ai ishte personi që fillimisht i kishte premtuar atij tenderin;
- Meqë M. Sh. nuk kishte dashur apo nuk kishte pasur mundësi të paguante ryshfetin, F.L. dhe E. Sh. kishin intensifikuar bisedimet me kompaninë Kompania T. në lidhje me dhënien e tenderit në fillim të vitit 2009. Më 10 mars 2009, pasi F. Z. i ishte ankuar E. SH. se nuk po merrte mjaftueshëm prapa për donacionin e tij për një parti udhëheqëse politike, në shumën prej 5.000,00 Euro, të cilën ai e kishte paguar më herët, E. Sh. kishte komunikuar me F.L. duke i thënë se “Kompania T. po thotë ti më ke tradhtuar mua”.
- Më 19 Mars 2009, E. Sh. i kishte thënë F. Z. nga kompania Kompania T. se ai – E. Sh. – “kishte biseduar me disa eprorë dhe ata më kanë premtuar mua se do ta japin ty mirëmbajtjen; natyrisht që unë u thashë atyre se edhe ti do t’i bësh të lumtur ata”. Dy ditë pas kësaj, më 21 Mars 2009, E. Sh. e kishte siguruar F.L. duke deklaruar në vijim: “... mos u brengos për mirëmbajtjen, unë merren me këtë punë vazhdimisht.”
- Më 23 mars 2009, ryshfeti ndërmjet E. Sh. dhe Kompania T. shkoi në fazën finale. F. Z. siguron E. Sh. se Kompania T. do të “kryejë obligimin ndaj teje [E. Sh.] dhe sigurisht edhe ndaj njerëzve tu” dhe se ai “do t’i jep ty [E. Sh.] 25 me katër zero”. E. Sh. u përgjigj duke thënë se ai “kishte biseduar me vëllain e shefit tonë më të madh dhe se ata to ta japin ty, por ti duhet ta mbash premtimin lidhur me 25 për të cilën biseduam.” Pak më pas, E. Sh. ndihmoi rregullimin e dokumenteve të Kompania T.t në atë mënyrë që të sigurohet që Kompania T. do të ishte oferta fituese.
- Pas shumë komunikimeve, më 27 mars 2009, Kompania T. kërkoi informacione të reja në lidhje me marrëveshjen për ryshfet, në të cilën E. Sh. u përgjigj “gjithçka po shkon mirë po presim që

kontrata të jetë e gatshme më pas mund ta nënshkruani, por para kontratës duhet t'i lëshoni sendet”.

- Një ditë më vonë, më 28 mars 2009, Kompania T. i shkruan E. SH. duke i thënë “Shpresoj se çështja e mirëmbajtjes do të jetë në favorin tonë, sepse ditët po afrohen dhe krejt jemi të lumtur” dhe se “ato para në xhep po më hanë” dhe se ata duhet të “shpejtojnë me qëllim që të jenë në gjendje ta bëjnë dorëzimin”. E. Sh. përgjigjet të njëjtën ditë duke shkruar se “shpresojmë se do të ndodh, hahaha, ato (paratë) po ju hanë? Ato do të dorëzohen, çka të bëjmë pasi që ato duhet t'ju jepen atyre të mëdhenjve”.
- Më 30 mars 2009, M. Sh. bëri përpjekjen e fundit të pasuksesshme për ta fituar tenderin siç i kishte premtuar F.L. më parë dhe kishte kërkuar një takim me të. Më 31 mars 2009, Kompania T. pranoi një njoftim nga numri +44-972-313 që ‘pasi që ke lidhje shumë të mira me burrështetas duket se puna do të kryhet.’ Gjatë procesit, tenderi iu dha Kompania T. për ofertën/vlerën prej 1.192.844,94 EUR.

4. **Pika 4 e aktakuzës kundër F. Z.: Dhënia e Ryshfetit në kundërshtim të nenit 344 paragrafi 1 të KPPK-së; e dënueshme me burgim prej tre muaj deri në tre vjet lidhur me nenin 117.1.a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015: Pika 4 e Aktakuzës REFUZOHET në pajtim me nenin 363, paragrafi 1 (1.3) të KPP-së, sepse ka kaluar afati i parashkrimit.**

5. **Pika 5 e Aktakuzës kundër F. Z.: Keqpërdorimi i Autorizimeve në Ekonomi në kundërshtim të nenit 236 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 dhe paragrafi 2 i KPPK-së; e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015: I akuzuari LIROHET NGA AKUZA në pajtim me nenin 364, paragrafi 1 (1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën është akuzuar, në mënyrë të veçantë:**

- Ndërmjet datës 21 mars 2008 deri më 17 prill në orën 13:00 2008 në Kosovë, F. Z. në cilësinë e pronarit të Kompanisë Kompania T. ka shkelur rregullat e veprimtarisë biznesore duke kryer, respektivisht duke toleruar një marrëveshje për rregullim të çmimit me kompaninë Z. C. Company, pronë e vëllait të tij N. Z., pa zbuluar se të dy kompanitë do të punonin së bashku; që përbën kështu shkeljen e nenit 66.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik;
- Ofertat, që janë paraqitur nga Kompania T. dhe Z. C. për këtë tender përmbajnë çmime identike në pozitat e kërkuara në të cilat ofertat është dashur të saktësohen. F. Z. kështu ka manipuluar, respektivisht ka toleruar manipulimin e procesit të ofertimit, i cili proces është dashur të jetë i paanshëm dhe sekret. F. Z. më tej ka ndërtuar rrugën me defekte duke e ditur se defektet e tilla zyrtarisht nuk do të pranoheshin nga MTPT. Ai ka kërkuar këshillim nga E.Sh i cili i kishte thënë atij të vazhdonte sepse për këtë nuk do të gjobitej;
- Sa i përket tenderit, Mirëmbajtja Verore për rrugët e rajonit të Gjilanit për vitin 2008, ndërmjet datës 11 shkurt 2008 dhe 24 prill 2008 në Kosovë, F. Z. në cilësinë e pronarit të kompanisë Kompania T. ka shkelur seriozisht rregullat e veprimtarisë biznesore duke kryer, respektivisht



toleruar një marrëveshje për rregullim të çmimit me kompaninë E., pronë e I. Sh., duke mos zbuluar se të dy kompanitë do të punonin së bashku; që përbën kështu shkeljen e nenit 66.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik;

- Ofertat, që janë paraqitur nga Kompania T. dhe E. për këtë tender kanë përmbajtur çmime identike në gjitha pozitat e kërkuara në të cilat ofertat është dashur të saktësohen. F. Z. kështu ka manipuluar dhe ka toleruar manipulimin e procesit të ofertimit, i cili proces është dashur të jetë i paanshëm dhe sekret. Tenderi ishte fituar nga kompania M.;
- Sa i përket tenderit Mirëmbajtja Dimërore për rrugët e rajonit të Gjilanit për vitin 2009, në mars të vitit 2009 në Kosovë, F. Z., si pronar i organizatës biznesore Kompania T., ka shkelur rregullat e veprimtarisë biznesore duke premtuar një ryshfet në shumën prej 250.000 EURO zyrtarit të MTPT-së E.Sh me qëllim që ai të fitonte tenderin e MTPT-së (shih specifikat në Pikat 5 dhe 6 të Aktakuzës). Më tej, F. Z. ka negociuar me E. SH. rregullimin e dokumenteve për tenderin e tij, që është një shkelje e kërkesave për të drejtën në pjesëmarrje që i ndalonte kompanisë së F. Z. Kompania T. që ligjërisht të merrte pjesë në aktivitetin e prokurimit. Gjatë negociimit të ryshfetit, F. Z. ka komunikuar privatisht me zyrtarin e MTPS-së E. Sh. gjatë periudhës së paraqitjes së ofertave dhe dhënies së kontratës, që përbën një shkelje tjetër të rregullave të veprimtarisë biznesore pasi që përbën sjellje të paligjshme dhe jo-transparente në kundërshtim me nenin 53 dhe 57.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

**6. Pika 6 e Aktakuzës kundër F.L.: Vepra të tjera penale në formë të mos-Deklarimit të Parave të Pranuarra për Fushatë në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale,** siç është ndryshuar, neni 5.1 lexuar me nenin 10.8 të dënueshme me burgim deri dy vjet dhe me gjobë deri në 5000 Euro apo me dyfishin e shumës së valutës së pranuar, cilado prej tyre që është më e lartë, neni 5.6 lexuar me nenin 10.5 e dënueshme me burgim deri pesë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 Euro siç përshkruhet në Aktakuzën e Bashkuar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015:

**Vepra penale e pranimit të një kontributi politik që tejkalon shumën prej 1.000 euro nga një burim i vetëm në një ditë të vetme sipas neneve 5.1 dhe 10.8 të Rregullores së UNMIK-ut REFUZOHET në pajtim me nenin 363, paragrafi 1 (1.3), sepse ka kaluar afati i parashkrimit.**

**I akuzuari LIROHET NGA AKUZA për veprën penale të mos zbulimit të qëllimshëm të informatave materiale në deklaratë sipas neneve 5.6 dhe 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut, në pajtim me nenin 364, paragrafi 1 (1.3), sepse nuk është provuar se ai ka kryer veprën me të cilën ai është akuzuar, në mënyrë të veçantë:**

- Më 18 tetor 2007, F.L. ka pranuar një kontribut në kampanjën politike nga I. M. për fushatën zgjedhore për Kryetar të Komunës së Prishtinës në 2007. Kontributi për fushatë ishte aranzhuar ndërmjet I.M. dhe E. SH. derisa F.L. ishte në vizitë në Gjermani. E.Sh ishte menaxher i kampanjës zgjedhore të F.L. gjatë kësaj kohe relevante. 5.000,00 EURO u transferuan nga I. M. në llogarinë private bankare të F.L. në Kosovë. Përkundër obligimit për të deklaruar 5.000,00

EURO si kontribut zyrtar për fushatën, F.L. nuk ka deklaruar zyrtarisht këtë shumë tek autoritetet përkatëse.

7. Palët e dëmtuara udhëzohen që ata të mund të parashtrojnë kërkesën e tyre pasurore-juridike në proces gjyqësor civil; ne pajtim me nenin 463 te KPP;

8. Shpenzimet e procedurës do të paguhen nga burimet buxhetore ne pajtim me nenin 450 dhe 454 te KPP;

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

**Nr. i rastit P8/13**

---

**Gjyqtarja e trupit gjykues**  
**Marie Tuma**

---

**Anëtarja e trupit gjykues**  
**Jennifer Seel**

---

**Anëtari i trupit gjykues**  
**Isuf Makolli**

---

**Procesmbajtësi:**  
**Azem Havolli**

**Mjeti juridik:** Në pajtim me nenin 380 të KPP-së, kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 15 ditëve nga dita kur kopja e Aktgjykimit iu është dorëzuar palëve. Ankesa duhet t'i adresohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore në Prishtinë.